

VENDIM
Nr. 7, datë 4.2.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRFAQËSUESIT TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NË BORDIN E PËRBASHKËT TË MENAXHIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL DHE AGJENCISË PËR ZHVILLIM
EKONOMIK RAJONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 3, të vendimit nr. 961, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Zëvendëskryetari i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, z. Niko Peleshi, të jetë përfaqësues i këtij Komiteti në Bordin e Përbashkët për Zhvillim të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal.

2. Ngarkohet Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për t’u komunikuar vendimin Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

